



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. 5453 prot.

Shkodër, më 7 3 . 2025

**VENDIM**

**Nr. 16, datë 03.03.2025**

**“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR.27, DATË 01.06.2016, PËR NGRITJEN E  
KËSHILLIT ARTISTIKO-KULTUROR, SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TIJ DHE  
MIRATIMIN E RREGULLORES SË FINANCIMIT TE PROJEKTEVE KULTURORE,  
ARTISTIKE, SPORTIVE, RINORE DHE PROMOVIMIN E TERRITORIT NË  
BASHKINË SHKODËR , TË NDRYSHUAR”**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 03.03.2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 8, pika 2, nenin 25, pikat 2 dhe 4, të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, Ligji Nr. 10352 datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar; Vendimin Nr.540, datë 21.12.1992 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e këshillave artistiko - kulturor dhe për shpërblimin e anëtarëve të tyre”, të ndryshuar; Udhëzimin Nr.1, datë 24.05.2005 të Ministrit të Kulturës Rinisë dhe Sporteve “Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këshillave artistiko - kulturor”, VKB Nr.27, datë 01.06.2016 “Per ngritjen e Keshillit artistiko kuturore, artistike, sportive dhe rinore, shpërblimin e anëtarëve të tij dhe miratimin e rregullores së financimit të projkteve kulturore, artistike, sportive dhe rinore në Bashkinë Shkodër”, të ndryshuar me VKB Nr. 40 datë 26.10.2023”, VKB Nr.76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër”, të ndryshuar, si dhe dokumentacionin e përgatitur nga administrata e Bashkisë Shkodër;

**VENDOSI :**

1. Të miratojë ndryshimin dhe zëvendësimin e anëtarëve të keshillit artistiko-kulturor të miratuar me VKB nr. 27 datë 01.06.2016 “Për Ngritjen e Këshillit Artistiko-Kulturor, shpërblimin e anëtarëve të tij dhe miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistike, sportive, rinore dhe promovimin e territorit në bashkinë shkodër” të ndryshuar me VKB nr. 40 datë 26.10.2023”, si më poshtë:

- Znj. Amila Gjyrezi zëvendësohet me Znj. Sara Smajaj Drejtor i Drejtorisë së Kulturës, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Drejtorisë së Kulturës dhe Sportit;
- Znj. Paskualina Gruda zëvendësohet me Z. Zef Çoba, kompozitor, Mjeshtër i Madh.

2. Pikat e tjera të VKB-se nr.27, datë 01.06.2016 “ Per ngritjen e Keshillit artistiko kuturore, artistike, sportive dhe rinore, shpërblimin e anëtarëve të tij dhe miratimin e rregullores së financimit të projekteve kulturore, artistike, sportive dhe rinore në bashkinë Shkodër” të ndryshuar me VKB nr. 40 datë 26.10.2023” mbeten në fuqi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Miratuar me 35 vota

Vota Pro	35
Vota Kundër	0
Vota Abstenim	0
Zbardhur me datë	04.03.2025

**SEKRETARE**

**Sabina Danaj**

**KRYETAR**

**Oltion EULI**

